

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ORGANIC FARMING ALBANIA (OFA) SHPK

Ne Tirane, sot me dt 30/04/2024 (dymije e njezete e kater), shtetasi:

Z. Frai Meçaj, lindur më 14 Shkurt 1991 në Tirane dhe banues ne Tirane, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i pasaportes me nr. BJ6584977 dhe numer personal J10214056I madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

E cila duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, ‘Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtarë’, ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë “Shoqeria”), me dispozitat e mëposhtme.

Neni 1
Emërtimi dhe selia e shoqërise

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësai të kufizuar është ORGANIC FARMING ALBANIA (OFA) SH.P.K..

Selia e shoqërisë ndodhet në: Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, Kati 2, Tirane, Shqipëri. Në këtë adresë ndodhet edhe Zyra Qëndrore e Shoqërise.

1.1 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti i Shoqërisë

2.1 Objekti i Shoqërisë është :

Qëllimi i kompanisë është të kryejë aktivitetet e mëposhtme: Ferme dhe te kryeje aktivitete te Bujqësise Organike dhe Rigjeneruese.

Per krverjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.

Aktivitetin e saj kjo firme mund ta ushtroje si ne Shqiperi ashtu edhe jashtë saj
Aktiviteti i shoqerise nuk do te kufizohet vetem ne keto sherbime apo veprimtari

2.2 Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara mund të bashkëpunojë me direk dhe indirekt me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog osë të lidhur me të tyren.

Neni 3
Kohëzgjatja e Shoqërise. Viti ushtrimor

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat te pacaktuar.

3.2 Viti i parë finanziar do të fillojë nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar, pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor.

3.3 Vitet e mëtejshme financiare fillojnë më 1 Janar dhe përfundojnë me 31 Dhjetor.

Neni 4
Kapitali themeltar



4.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 Lekë (dhjetemije Lekë) dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote me vlerë nominale të barabartë prej 10,000 (dhjetemije Lekë) Lekë.

4.2 Ortaku i vetem themelues Z. Frai Meçaj Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë nominale të barabartë prej 10,000 (dhjetemije Lekë) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

4.3 Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote me vlerë nominale të barabartë prej 10,000 (dhjetemije Lekë) Lekë.

Neni 5 **Asambleja e Përgjithshme**

5.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për cështjet e përcaktuara në Ligjin per Shoqerte tregtare. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet dhe sipas mënyrës së thirrjes të përcaktuara në statusin e shoqërisë.

Neni 6 **Administratori**

6.1 Shoqëria do të administrohet nga një Administrator. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Z. Frai Meçaj. Afati i emërimit të Administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëriturje.

Neni 7 **Kostot e themelimit**

7.1 Të gjitha kostot, pagesat dhe shpenzimet lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë do të merren përsipër nga shoqëria të cilat do të përfshihen në llogarinë e parë vjetore financiare në shumën e atyre aktuale.

Neni 8 **Njoftimet**

8.1 Njoftimet për oratakët do të kryhen me postë të regjistruar në adresën e kompanise më të fundit të komunikuar nga cdo ortak, me përashtim kur parashikohet ndryshe nga ligji apo statuti.

8.2 Njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës elektronike, në momentin e krijimit të ksuheteve teknike që kërkohen sipas ligjit.

Neni 9 **Dispozita të fundit**

9.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë akt themelimi, me statutin e saj dhe ligjin shqiptar.

Neni 10 **Kopje**

10.1 Ky akt themelimi hartohet në 3 kopje, sipas këtij destinacioni, një kopje orataku, një kopje për Qëndrën Kombetare të biznesit dhe një kopjë për zyrën qëndrore të shoqërisë.

O R T A K U I V E T E M

**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ORGANIC FARMING ALBANIA (OFA) SH.P.K.**

Frai Meçaj

*FRAI MEÇAJ
30/04/2024*